



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Qendron Kastrati, Kryetar

Adresa: Rr.Skenderbeu, Kamenicë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kamenicës (Komuna e Kamenicës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kamenicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna e Kamenicës kishte mbivlerësuar pasuritë kapitale në vlerë prej 1,249,436€, kjo vlerë kryesisht ka të bëjë me pronën (toka) që nuk është pjesë e komunës, ekziston në regjistrin e pasurisë së komunës, Në anën tjetër, kishte nënvlerësim të pasurisë kapitale për 140,027€, për shkak të regjistrimit të gabuar në vlerë të pasurisë dhe mos regjistrimit të pasurisë në sistemin e-pasuria. Po ashtu, ka mangësi edhe në zhvlerësimin e pasurisë.

Gjatë auditimit, Komuna përmes kërkesës në Thesar, ka bërë korigjimet në SIMFK, ashtu që pronat që nuk janë pronë e saj, janë larguar nga regjistrat e pasurisë si dhe janë bërë edhe korigjimet tjera, ndërsa çështja e zhvlerësimit mbetet të bëhet në fund të vitit sipas procedurave të sistemit në Thesar. Përkundër kërkesës së komunës në Thesar për korigjim të PVF, për shkak të limiteve kohore, kjo nuk ka ndodhur.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Konkluzion i Pamodifikuar për Pajtueshmërinë. Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Kamenicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komuna e Kamenicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se Komuna kishte bërë pagesa nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve dhe Investimeve kapitale, në bazë të vendimeve gjyqësore, shumën prej 38,455€ për kompensimin e pagave jubilarë. Pra kategoria e pagave dhe meditive është mbivlerësuar për 38,455€, ndërsa është nënvlerësuar kategoria e mallrave dhe shërbimeve për 36,416€ dhe kategoria e investimeve kapitale për 2,039€. Poashtu, për shpenzimet të shpronësimit, komuna kishte paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve vlerën prej 9,046€, duke mbivlerësuar këtë kategori dhe nënvlerësuar kategorinë e investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur për arsyen se : (1) me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike, dhe (2) për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të Vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit, dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.

Duke qenë se ky problem është mjaft i përhapur edhe te organizatat tjera, më hollësisht do të trajtohet te Raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kamenicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Kamenicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kamenicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kamenicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kamenicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja

Rregulla MF-02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare në Organizata Buxhetore, Neni 6, pika 3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Komuna e Kamenicës kishte bërë evidentimin dhe vlerësimin e pasurive komunale tek në vitin 2003, ndonëse kjo nuk ishte e harmornizuar me regjistrin e pasurisë. Më tej, derisa Ranillugu ishte themeluar Komunë, prona e saj ishte në kuadër të Komunës së Kamenicës. Mirëpo, nga ky akt, nuk kishte ndërmarrë veprime që pronat e Komunës së Ranillugut ti largoj nga regjistrat e Komunës së Kamenicës. Si pasojë, toka me vlerë prej 1,227,697€ e cila i takon Komunës së Ranillugut gjendej edhe në regjistrat e pasurisë të Komunës së Kamenicës, me ç’ rast pasuria ishte mbivlerësuar për këtë vlerë.

Tre (3) pagesa të cilat kishin të bëjnë me pastrim, mirëmbajtje të rrugëve dhe parqeve në vlerë prej 21,739€ ishin regjistruar si pasuri kapitale, Komuna e Kamenicës kishte nënvlerësuar pasurinë kapitale për 140,027€, kjo vlerë është nga nënvlerësimi i Shkollës në Roganë në vlerë 122,013€ dhe 18,014€ pasi që nuk kishte regjistruar pronën e cila ishte paguar në bazë të vendimit Gjyqësor. Po ashtu Komuna kishte nënvlerësuar pasurinë nën 1,000€ për vlerën 61,587€, ku katër (4) pagesa nuk ishin regjistruar në e-pasuri.

Më tej Ambulanta në Hodonovc në vlerë prej 12,763€ dhe Rregullimi i ujrave dhe kanalizimit në Hodonovc në vlerë prej 14,856€, figuronin si pasuri e Komunës në regjistra të pasurisë por nuk është ofruar dokumentacion për vlerat financiare dhe prejardhjen e tyre.

Komuna në regjistrin e evidentimit dhe të vlerësimit të pasurisë së vitit 2003 kishte evidentuar pasuritë (1), por vlera e tyre nuk përputhet me atë të paraqitur në PFV.

Vlera neto e pasurive nën 1,000€ e paraqitur në PFV është 192,123€, por ajo nuk është e zhvlerësuar në sistemin e-pasuria.

Gjatë auditimit, Komuna përmes kërkesës në Thesar, ka bërë korigjimet në SIMFK, ashtu që pronat që nuk janë pronë e saj, janë larguar nga regjistrat e pasurisë si dhe janë bërë edhe korigjimet tjera, ndërsa çështja e zhvlerësimit mbetet të bëhet në fund të vitit sipas procedurave të sistemit në Thesar. Përkundër kërkesës së komunës në Thesar për korigjim të PVF, për shkak të limiteve kohore, kjo nuk ka ndodhur.

Ndikimi

Mos shlyerja e pasurisë nga regjistrat me rastin e transferimit të saj, regjistrimi i pasurisë në regjistra të pasurisë pa dokument mbështetës, mos regjistrimi i vlerës së saktë të pasurisë ndikon në mbivlerësim/nënvlerësimin e regjistrit të pasurive, dhe kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PFV të mos jenë të sakta.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se pasuria që nuk është nën kontroll të entitetit të largohet nga regjistrat e pasurisë, artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë.

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për Subvencione dhe Transfere ishte 400,466€, prej të cilave në 2020 ishin shpenzuar 383,499€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me pagesa për përfitues individual, subvencione për entitete publike etj. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 37,116€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Vlerësimi i aplikacioneve jo në pajtim me Thirrjen Publike

Gjetja Thirrja Publike për aplikim për subvencion në projektin për “Mekanizëm bujqësor” në Komunën e Kamenicës, përmban kriteret në bazë të cilave do të vlerësohen aplikuesit, si sipërfaqja e tokës, posedim i traktorit, kopja e letërnjoftimit, vërtetimi mbi tatimin në pronë, fleta poseduese e tokës dhe certifikata e fermerit.

Për këtë proces, kemi testuar 17 lëndë të aplikuesve dhe kemi gjetur se gjatë vlerësimit janë përdorë kriteret të cilat nuk kanë qenë pjesë e Thirrjes Publike për të eliminuar jo-përfituesit si: aplikuesi ka të punësuar në familje, ka gjendje të mirë ekonomike, ka mekanizmin e kërkuar, ka qenë përfitues nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe se ka qenë përfitues i Grantëve nga MBPZHR. Po ashtu, ne dy raste kemi vërejtur se aplikantët janë eliminuar edhe pse i kanë plotësuar kriteret. Zyrtarët komunal nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim.

Ndikimi Përdorimi i kriterëve të pa përcaktuara në Thirrjen Publike, krijon mundësinë e përzgjedhjes së përfituesve jo meritore dhe rritë rrezikun që kriteret e përdorura të përshtaten për grupe të caktuara të aplikantëve dhe manipulimet me procesin.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të cilët janë pjesë e komisionit të vlerësimit, të vlerësojnë aplikacionet në pajtim të plotë me kriteret e vendosura në Thirrjen Publike. Gjithashtu komisionet të mos përdorin kriteret të cilat nuk kanë qenë të publikuara, janë diskriminuese, apo të cilat aplikuesit nuk dinë se duhet t'i plotësojnë.

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mos përgatitja planit vjetor për mbështetje financiare për OJQ

Gjetja Rregullorja e MF - Nr. - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik Të OJQ-ve, Neni 6.1 përcakton se “Ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës”.

Komuna nuk kishte përgatitur Planin Vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve.

Komuna Planin Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të e kishte përgatitur vetëm për vitin 2021.

Ndikimi Mos përgatitja e planit vjetor për mbështetje financiare të OJQ-ve, paraqet mungesë të informatave së cilat fusha do përkrahën nga Komuna, si dhe qëllimet se për çfarë janë të parapara këto mjete.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 63,651,988€, pasurive jokapitale është 192,123€, si dhe e stoqeve 554€. Në këtë fushë, kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 460,264€, si dhe kemi bërë katër (4) teste të pajtueshmërisë.

Çështja B4 - Mangësitë në procesin e Inventarizimit të pasurive

Gjetja

Sipas Rregullores 02/2013 mbi Pasurinë Jo-financiare, Neni 18 përcakton se inventarizimi i pasurisë bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo-financiare dhe sipas nenit 19.4.3 Komisioni është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Komisionin për inventarizimin e pasurisë, ka përgatitur një raport të inventarizimit i cili përmban vetëm pasuritë jashtë përdorimit, por nuk është bërë edhe inventarizimi i pasurisë në përdorim që ka Komuna.

Zyrtarët komunal nuk kanë ofruar sqarime për mos zbatim të kërkesave të rregullores së lartë shënuar.

Ndikimi

Mos paraqitja e pasurive të cilat janë në përdorim nga Komuna në raportin e inventarizimit, pasqyron dobësi në menaxhimin e pasurive, pasi që nuk dihet numri i artikujve të cilët janë në përdorim nga zyrtarët komunal.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë se inventarizimi i pasurisë të kryhet sipas rregullores në fuqi, ku pjesë përbërëse e raportit të inventarizimit të jetë edhe pasuria e cila është në përdorim nga zyrtarët komunal.

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV-të e vitit 2020 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,159,940€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 1,567,690€, nga taksa komunale në vlerë prej 420,801€, nga qiraja në vlerë prej 22,953€, taksa komunale për leje ndërtimi 67,976€ dhe nga shfrytëzimi i pronës publike në vlerë prej 80,520€.

Çështja B5 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe sipas nenit 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtyrë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.

Në anën tjetër sipas rregullores 01/2016 për ngarkesa, taksa tarifa dhe gjoba komunale, neni 8 pika 8 parasheh se tarifatat janë vjetore dhe paguhen në dy këste (kësti i parë deri me 15 qershor dhe kësti i dytë deri me 15 dhjetor).

Për të arkëtueshmet nga Taksa Komunale për Regjistrim Biznesi, dhe nga Taksa për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe Qiraja, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e tyre siç parashihet me rregullore.

Shpjegimi nga zyrtarët komunal ishte se nuk janë marrë masa konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme për shkak të Pandemisë.

Ndikimi

Mos aplikimi i mekanizmave të përcaktuar me ligj dhe rregullore përkatëse ndikon në rritje të vazhdueshme të këtyre llogarive, që rezulton me fonde të pakta për arritjen e synimeve dhe mund të ndikoj edhe tek debitorët e tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	9,401,944.00	10,061,790.58	9,516,804.42	9,050,688.87	8,735,011.24
Grante Qeveritare - Buxheti	8,539,870.00	8,767,239.64	8,614,281.38	7,979,944.87	8,008,232.52
Financimi përmes huamarrjes	0.00	73,710.00	73,710.00	6,035.00	2,655.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	330,898.14	257,671.52	296,660.29	143,724.63
Të hyrat vetanake	862,074.00	862,074.00	558,385.52	696,647.77	568,584.09
Donacionet vendore	0.00	25,384.36	12,756.00	71,400.94	11,815.00
Donacionet e jashtme	0.00	2,484.44	0.00	0.00	0.00

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 659,846€. Kjo rritje është rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti i kaluar, Vendimeve të Qeverisë dhe donacioneve.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 9,516,805€ me një përmirësim 3% në krahasim me vitin 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,401,944.00	10,061,790.58	9,516,804.42	9,050,688.87	8,735,011.24
Pagat dhe mëditjet	7,145,774.00	7,235,044.15	7,169,057.38	6,876,337.83	6,899,838.84
Mallrat dhe shërbimet	900,000.00	1,350,872.83	1,058,131.27	787,974.84	691,872.05
Komunalitë	184,000.00	185,075.06	172,612.41	185,832.71	162,920.98
Subvencionet dhe transferet	120,000.00	400,466.07	383,499.04	200,812.94	112,765.07
Investimet Kapitale	652,028.00	890,332.47	733,504.32	999,730.55	867,614.30
Rezervat	400,142.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Ndryshimet e buxhetit të Pagave dhe Mëditjeve për 89,270€ ishin nga rritja: 96,705€ nga rezervat, 36,960€ sipas vendimit të Qeverisë 06/38 për Zjarrëfiksët, 73,710€ nga huamarrja, si dhe zvogëlimet sipas Vendimit të Qeverisë nr 08/50 në vlerë prej 73,710€, dhe zvogëlimi sipas vendimit të Qeverisë nr 09/50 prej 44,395€ për harmonizimet e brendshme të pagave.

Buxheti për Mallra dhe Shërbime ishte rritur për 450,873€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vie nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e të hyrave vetjake të pashpenzuara nga viti 2019 në vlerë prej 165,225€, rritja prej 124,361€ nga Vendimi i Qeverisë 01/23 për Planin për zbatimin e Programit për Rimëkëmbje Ekonomike, rritja prej 39,633€ nga Vendimi i Qeverisë 01/27 për Master Planin për zhvillimin e mësimin në kushte pandemie, rritja prej 1,654€ të bartura nga grantet e donatorve të jashtëm, dhe shuma prej 120,000€ nga Vendimi i Kuvendit Komunal si transfer për shpërndarjen e rezervave.


Buxheti i Shërbimeve Komunale ishte rritur për 1,075€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake në vlerë 8,554€ si dhe zvogëlimi sipas Vendimit të Qeverisë në vlerë 7,479€.

Buxheti për kategorinë e subvencioneve ishte rritur për 280,466€ krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vie nga Vendimi i Kuvendit Komunal për bartjen e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti i kaluar në vlerë prej 16,350€, rritja prej 12,116€ nga donacionet e brendshme, rritja prej 132,000€ nga Vendimi i Qeverisë 01/23 për Planin për zbatimin e Programit për Rimekëmbje Ekonomike, rritja prej 100,000€ ishte nga Vendimi i Kuvendit Komunal për transfer të rezervës në këtë kategori dhe 20,000€ ishte rritje nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 11/29.


Buxheti për shpenzime kapitale ishte rritur për 238,304€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vie nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2019 në vlerë prej 140,769€, rritja nga donacionet e jashtme prej 14,098€ dhe nga Vendimi i Kuvendit Komunal për transferin e mjeteve financiare nga rezerva në shumë prej 83,437€.

Shpenzimet për menaxhimin e situatës së Pandemisë Covid-19 ishin në vlerë prej 687,688€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Kamenicës në 2020 ishin në vlerë 636,097€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Poashtu Komuna e Kamenicës kishte inkasuar edhe të hyra indirekte në vlerë prej 136,748€. Kjo shumë përbëhet nga Gjocat e Policisë në vlerë prej 109,069€, gjocat nga Gjykata në vlerë prej 280€ dhe nga Gjocat e Agjencisë së Pyjeve të Kosovës në vlerë prej 27,399€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	862,074.00	862,074.00	636,096.96	745,860.38	764,439.83
Të hyrat tatimore	378,864.00	378,864.00	314,077.61	368,998.54	320,975.45
Të hyrat jo tatimore	483,210.00	483,210.00	322,019.35	376,861.84	443,464.38

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Kamenicës ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tri (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) nuk është i aplikueshëm më dhe pesë (5) nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr.4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria që nuk është nën kontroll të entitetit të largohet nga regjistrat e pasurisë, artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë si dhe në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të cilët menaxhojnë sistemin e-pasuria të bëhet zhvlerësimi i saj.	Ndonëse komuna ka bërë përmirësimet gjatë auditimit, megjithatë, në PVF-të e vitit 2020 situata është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar, për më shumë shih Theksimin e Çështjes.	Nuk është i aplikueshëm më

3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të cilët janë pjesë e komisionit të vlerësimit, të vlerësojnë aplikacionet në pajtim të plotë me kriteret e vendosura në Thirrjen Publike. Gjithashtu komisionet të mos përdorin kritere të cilat nuk kanë qenë të publikuara, janë diskriminuese, apo të cilat aplikuesit nuk dinë se duhet t'i plotësojnë.		Nuk ka filluar zbatim
4.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.		Nuk ka filluar zbatim
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e kontraktimit të punëve duhet të sigurohen paraprakisht se nivelet kompetente kanë hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.		I zbatuar
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se inventarizimi i pasurisë të kryhet sipas rregullores në fuqi, ku pjesë përbërëse e raportit të inventarizimit të jetë edhe pasuria e cila është në përdorim nga zyrtarët komunal.		Nuk ka filluar zbatim
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.		Nuk ka filluar zbatim
8.	Obligimet e papaguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve të bëhet vetëm atëherë kur Komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.		I zbatuar
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se prezantimi i detyrimeve bëhet në vlerën saktë sipas kërkesave të Ligjit për menaxhimin e financave publike.		I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se pasuria që nuk është nën kontroll të entitetit të largohet nga regjistrat e pasurisë, artikujt e blerë të regjistrohen në regjistrat përkatës të pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurisë si dhe në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të cilët menaxhojnë sistemin e-pasuria të bëhet zhvlerësimi i saj.
2.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të cilët janë pjesë e komisionit të vlerësimit, të vlerësojnë aplikacionet në pajtim të plotë me kriteret e vendosura në Thirrjen Publike. Gjithashtu komisionet të mos përdorin kritere të cilat nuk kanë qenë të publikuara, janë diskriminuese, apo të cilat aplikuesit nuk dinë se duhet t'i plotësojnë.
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se përgatitet Plani Vjetor për Mbështetje Financiare për OJQ-të dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare.

4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se inventarizimi i pasurisë të kryhet sipas rregulloreve në fuqi, ku pjesë përbërëse e raportit të inventarizimit të jetë edhe pasuria e cila është në përdorim nga zyrtarët komunal.
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, licencat e bizneseve dhe të borxheve të tjera dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Pleurat Isufi, Udhëheqës i ekipit



Milos Petrovic, Anëtar i ekipit



Gazmend Namani, Anëtar i ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Komuna e Kamenicës kishte bërë evidentimin dhe vlerësimin e pasurive komunale tek në vitin 2003, ndonëse kjo nuk ishte e harmornizuar me regjistrin e pasurisë. Më tej, derisa Ranillugu ishte themeluar Komunë, prona e saj ishte në kuadër të Komunës së Kamenicës. Mirëpo, nga ky akt, nuk kishte ndërmarrë veprime që pronat e Komunës së Ranillugut ti largoj nga regjistrat e Komunës së Kamenicës. Si pasojë, toka me vlerë prej 1,227,697€ e cila i takon Komunës së Ranillugut gjendej edhe në regjistrat e pasurisë të Komunës së Kamenicës, me ç' rast pasuria ishte mbivlerësuar për këtë vlerë.</p> <p>Tre (3) pagesa të cilat kishin të bëjnë me pastrim, mirëmbajtje të rrugëve dhe parqeve në vlerë prej 21,739€ ishin regjistruar si pasuri kapitale, Komuna e Kamenicës kishte nënvlerësuar pasurinë kapitale për 140,027€, kjo vlerë është nga nënvlerësimi i Shkollës në Roganë në vlerë 122,013€ dhe 18,014€ pasi që nuk kishte regjistruar pronën e cila ishte paguar në bazë të vendimit Gjyqësor. Po ashtu Komuna kishte nënvlerësuar pasurinë nën 1,000€ për vlerën 61,587€, ku katër (4) pagesa nuk ishin regjistruar në e-pasuri.</p> <p>Më tej Ambulanta në Hodonovc në vlerë prej 12,763€ dhe Rregullimi i ujrave dhe kanalizimit në Hodonovc në vlerë prej 14,856€, figuronin si pasuri e Komunës në regjistra të pasurisë por nuk është ofruar dokumentacion për vlerat financiare dhe prejardhjen e tyre. Komuna në regjistrin e evidentimit dhe të vlerësimit të pasurisë së vitit 2003 kishte evidentuar pasuritë(1), por vlera e tyre nuk përputhet me atë të paraqitur në PFV.</p> <p>Vlera neto e pasurive nën 1,000€ e paraqitur në PFV është 192,123€, por ajo nuk është e zhvlerësuar në sistemin e-pasuria.</p>	<p>Ne momentin që janë identifikuar këto gabime, ne kemi bërë korigjimin gjatë vitit 2021, por ndyrshimet nuk janë reflektuar retroaktivisht në regjistrat kontabël të pasurisë në SIMFK. Megjithatë, në PF 2020 ne kemi bërë shpalosjet në nenin 19 të cilat reflektojnë gjendjen aktuale dhe kemi adresuar mangësitë e identifikuar. Bashkangjitur PF 2020 të korigjuara, numri i protokolit MF: 3196</p>	<p>Kjo çështje është sqaruar edhe në brendi të raportit. Konkluzioni i juaj është i saktë për hapat që keni ndërmarrë, megjithatë ne kemi dhënë opinionin mbi PFV-të e vitit 2020.</p>

<p>Gjatë auditimit, Komuna përmes kërkesës në Thesar, ka bërë korigjimet në SIMFK, ashtu që pronat që nuk janë pronë e saj, janë larguar nga regjistrat e pasurisë si dhe janë bërë edhe korigjimet tjera, ndërsa çështja e zhvlerësimit mbetet të bëhet në fund të vitit sipas procedurave të sistemit në Thesar. Përkundër kërkesës së komunës në Thesar për korigjim të PVF, për shkak të limiteve kohore, kjo nuk ka ndodhur.</p>		
<p>Thirrja Publike për aplikim për subvencion në projektin për “Mekanizëm bujqësor” në Komunën e Kamenicës, përmban kriteret në bazë të cilave do të vlerësohen aplikuesit, si sipërfaqja e tokës, posedim i traktorit, kopja e letërnjoftimit, vërtetimi mbi tatimin në pronë, fleta poseduese e tokës dhe çertifikata e fermerit.</p> <p>Për këtë proces, kemi testuar 17 lëndë të aplikuesve dhe kemi gjetur se gjatë vlerësimit janë përdorë kritere të cilat nuk kanë qenë pjesë e Thirrjes Publike për të eliminuar jo-përfituesit si: aplikuesi ka të punësuar në familje, ka gjendje të mirë ekonomike, ka mekanizmin e kërkuar, ka qenë përfitues nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, dhe se ka qenë përfitues i Grantëve nga MBPZHR. Po ashtu, në dy raste kemi vërejtur se aplikantët janë eliminuar edhe pse i kanë plotësuar kriteret. Zyrtarët komunal nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim.</p>	<p>B2 Pajtohemi, lidhur me thirrjen Publike për aplikim për subvencion në projektin për “Mekanizëm bujqësor”.</p>	
<p>Komuna për të arkëtueshmet nga tatimi në pronë, nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë.</p> <p>Në anën tjetër sipas rregullores 01/2016 për ngarkesa, taksa tarifa dhe gjopa komunale, neni 8 pika 8 parasheh se tarifat janë vjetore dhe paguhen në dy këste (kësti i parë deri me 15 qershor dhe kësti i dytë deri me 15 dhjetor).</p> <p>Për të arkëtueshmet nga Taksa Komunale për Regjistrim Biznesi, dhe nga Taksa për shfrytëzimin e hapësirave publike dhe Qiraja, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e tyre siç parashihet me rregullore.</p>	<p>Pajtohemi.</p>	

Komisionin për inventarizimin e pasurisë, ka përgatitur një raport të inventarizimit i cili përmban vetëm pasuritë jashtë përdorimit, por nuk është bërë edhe inventarizimi i pasurisë në përdorim që ka Komuna.	Pajtohem.	
Menaxhimi I llogarive të arketueshme	Pajtohem.	

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁸ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Ndërtesa e kadastrit ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë (SIMFK) me vlerë prej 107,570€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 139,536€; Shkolla Fillore në Topanicë ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 23,610€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 314,087€; Shkolla Fillore në Sterzoc ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 185,344€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 246,572€; Shkolla fillore në Dazhdincë ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 6692€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 8,892€; Objekti shëndetësor reparti i fëmijëve ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 41,882€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 55,717€; Ngrohtorja në objektin shëndetësor ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 55,922€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 74,382€; Ambullanta në Lisockë ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 22,731€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 30,240€; Ambullanta në Roganë ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 10,724€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 139,095€; Shkolla fillore në Kopernicë ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 225,875€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 292,980€; Shkolla fillore Fan Noli, Drejtoria ishte regjistruar në regjistrin e pasurisë në vlerë prej 169,595€ ndërsa sipas vlerësimit të komisionit vlera fillestare e kësaj pasurie ishte 225,620€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.